



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 2403/2 Prot.

Tiranë, më 15.11.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1675, datë 06.09.2016.

**SHOQËRISË “VIKTORIA INVEST” SH.A**  
**Lagjia “28 Nëntori”, Rr. “11 Nëntori”, Pranë Tatim Taksa, Kati 2, Elbasan**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**  
**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “VIKTORIA INVEST” sh.p.k, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1675, datë 06.09.2013, për mineralin Gur Gëlqeror në objektin “Fushë Krujë”, Qarku Durrës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1092, datë 05.03.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.2403, Prot, datë 08.03.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1675, datë 06.09.2013, për mineralin Gur Gëlqeror, në objektin “Fushë Krujë”, Qarku Durrës, sepse në objekt nuk është punuar që nga momenti i marrjes së lejes minerare deri me sot.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1675, datë 06.09.2016, për mineralin Gur Gëlqeror, në objektin “Fushë Krujë”, Bashkia Fushë Krujë, Qarku Durrës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit **Nr.1675, datë 06.09.2016, për mineralin Gur Gëlqeror, në objektin “Fushë Krujë”, Bashkia Fushë Krujë, Qarku Durrës.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

